

SABRI HAMITI

FAIK KONICA :

BIBLIOTEKA

6



JAM UNE

8H.09

H23

SABRI HAMITI

FAIK KONICA:
JAM UNE



SHTEPJA BOTUESE E LIDHJES SE SHKRIMTAREVE
SHTEPJA BOTUESE ONUFRI

Tiranë 1994

PARAFRAZE E FAIK KONICES

Pse një figurë kaq e madhe letrare e atdhetare është nxjerrë nga letërsia shqipe, është pyetje që kërkon përgjigje nga krijuesit e brezit tim, duke ditur që ky nuk është paradoksi i vetëm i kësaj kulture. Përgjigja duhet të kërkohet në shoqërinë shqiptare, në shpirtin shqiptar, në kulturën shqiptare. Këtu për këtu del se arsyet e këtij paradoksi më parë janë letrare se sa ideologjike. Thënia "Kush hedh baltë në kulturën shqipe do ta pësojë si Faik Konica", të cilën e shqiptonin vetë krijuesit shqiptarë deri në vitet tetëdhjetë, pandërmjetshëm e tregon këtë. Anatemohet një model krijues përpara se një ideologji. Modeli i krijuesit kritik, shembull i parë i të cilit ishte Faik Konica në letërsinë shqipe, nuk kishte si të kalonte mirë në kulturën e **lavdit e të mitit**. Kjo mosmarrëveshje kulturore, duke u nxjerrë nga niveli letrar në nivelin shoqëror, shpejt e lehtë merr trajtën e anatemës për krijuesin; çështja letrare kthehet në çështje ideologjike. Mënyra më e lehtë, madje e provuar, që të bëhet anatema është kur vepra nuk njihet, por njihet vetëm një mendim i shfaqur për të, që pretendon të bëhet mendim i përgjithshëm.

I vetëdijshtëm se shkrimtari është një dhe se shpëtimi i tij është vetëm leximi dhe botimi i veprës së tij, ia pata nisur punës që të përmbush këtë hapësirë boshe në kulturën e në kritikën tonë, në pranverën e vitit 1991, punë që ma mori gjithë verën e më sollti në vjeshtë. Me që veprat e Konicës, të shkapërderdhura në revista e fletore, gjenden vështirë, sidomos tani kur nuk ka bibliotekë shqiptare në Prishtinë dhe, me që s'ka asnjë bibliografi të

plotë të veprave të këtij autori deri më sot, puna më e vështitë u bë kontakti me veprën e shkrimtarit.

Këto rrethana pa dyshim kanë ndikuar në mënyrën e leximit të kësaj vepre, duke i pasë marrë në dorë të dozuara një -nga një, për të krijuar habinë dhe paradoksin e **rizbulimit** të teksteve letrare edhe njëshekullore. Rrethanë tjetër që ndikon në shkrimin është veta koha dhe vendi ku bëhet ky lexim i Konicës (Prishtina e vitit 1991), që nëse nuk bën tjetër, duke peshuar mbi lexuesin e kësaj vepre, e bën të vetëdijshëm se nga rrethanat duhet të kalojë në vepër, se nëse kërkohet subjektiviteti e personaliteti i shkrimtarit, ai do të gjendet i plotë në shkrimin e tij, në veprën e tij letrare.

Kjo vetëdije, jo vetëm se të çon në leximin sistematik të veprës letrare në të gjitha njësitë e saj, nga më të voglat deri te tërësitë, por të shpie nga një **kritikë dialogjike**, e propozuar së voni nga Cvetan Todorovi, po e hetuar që moti nga Mihail Bahtini. Principi dialogjik i veprës së Konicës dhe i kritikës së saj sot, bëhet princip kryesor i ndërkomunikimit letrar në kulturën shqipe. Në këtë proces krijues e rikrijues takohen me njëri tjetrin dy subjektivitete, duke e thënë secili botën vet dhe duke e shenjuar kohën e vet të përmbyllur të shkrimit letrar. Kështu, interkomunikimi letrar bëhet interkomunikim i dy kohëve, që i ngjajnë njëra tjetrës tragjikisht. Shpëtimi nga shkarjet, kur flitet e kur shkruhet për letërsinë, është mbetja përherë në botën dhe në nivelin e letërsisë. Në këtë kuptim, edhe esetë në vazhdim janë dhe duhet të konsiderohen si **parafrazë** e letërsisë së Faik Konicës, që do të thotë njohje me natyrën e saj, pa e gjykuar së jashtmi.

Sabri Hamiti

Prishtinë, vjeshtë, 1991

BIBLIOGRAFI E FAIK KONICES

A. Shkollimi

Faik Konica, i biri i Shahin beut, lindi më 15 mars të vitit 1876 në Konicë. Nga ana e babait ishte pasardhës i bejlerëve të Konicës, kurse nga ana e nënës pasardhës i bejlerëve të Delvinës. Në mituri mësuesit privatë ia mësuan arabishten; në moshën nëntëvjeçare mësoi një vit në shkollën jezuite të Shkodrës; kur u kthye në vendlindje mësoi në shkollën e ulët greke, se nuk kishte shkolla shqipe. Mbas një viti u regjistrua në Liceun Perandorak të Stambollit, një shkollë e mesme e fortë, ku mësimi jipej në frëngjishte. Më 1890, si katërmëdhjetëvjeçar, shkoi në Francë dhe dy vite mësoi në Kolegjin në Lizje (Normandi), ku u shqua në letërsi klasike. Më 1892 u regjistrua në Liceun Qeveritar të Karaskonës, ku studioi letërsinë dhe filozofinë, ku fitoi shpërblimin më të lartë për kulturë të përgjithshme, apo **le prix d'honneur de rhétorique**, si dhe shpërblimet për hartime në frëngjishte e në latinisht. Më 1895 kreu me sukses studimet në letërsi e në filozofi në Universitetin Shtetëror të Dizhonit. Nga Dizhoni shkon në Paris, ku jetoi dy vjet dhe ndoqi kursin e letërsisë frënge të Mesjetës, të latinishtes dhe të greqishtes në Kolegjin e Francës. Shkollimin e mbaroi në Universitetin e Harvardit;

kurse më 1912 u bë magjistër i artit e i letërsisë.

B. Veprimtaria

Më 25 mars 1897 Faik Konica, në moshën njëzetënjëvjeçare, në Bruksel të Belgjikës, e nxori numrin e parë të revistës **Albania**, e cila doli deri më 1909 në Bruksel e në Londër. Mendohet se vepra e tij atdhetare fillon intensivisht me botimin e revistës, po simbas dëshmisë së autorit tonë në **Parashtresën mbi lëvizjen kombëtare shqiptare** (1899), Konica që nga viti 1890 merrej me çështjen shqiptare, madje shkruante artikuj në frëngjisht; në anën tjetër mblidhte gjithë veprat e albanologëve, kurse nga viti 1895 edhe veprat e shqiptarëve të kohës. Revista e tij u ndihmua nga qeveria e Austro-Hungarisë, që e nxiste lëvizjen kombëtare shqiptare, si pengesë për shtrirjen e sllavëve në Ballkan. Mbas pesë vitesh, më 1902 Konica kalon në Londër, ku e nxirte **Albaninë** dhe në Muzeun Britanik hulumtonte dorëshkrimet venedikase mbi Shqipërinë, sidomos të periudhës së Skënderbeut. Në vjeshtën e viti 1909 arriti në Boston dhe u bë kryeredaktor i gazetës **Dielli**, ku ndejti gjashtë muaj. Më 1911, më 20 mars, në Sent Luis e themeloi të përkohshmen **Trumbeta e Krujës**, e cila pushoi mbas disa muajve. Konica u kthye në Boston dhe bashkë me Fan S. Nolin e të tjerë themeloi Federatën Pan-Shqiptare **Vatra** të Amerikës, që do të mbronte pavarësinë dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë së posaformuar. Këtu Konica u bë sekretar i **Vatrës** dhe kryeredaktor i **Diellit**, që tashti u bë organ zyrtar i saj.

Më 1912 Vatra e dërgon Konicën delegat pranë Konferencës së Ambasadorëve në Londër për krijimin e

shtetit shqiptar. Më 1913 e viziton Shqipërinë dhe është i pakënaqur. E kishte inat Ismail Qemalin, kryetarin e përkohshëm të shtetit; e le Vlorën, kryeqytet, dhe shkon në Durrës ku u bashkohet forcave të Esad Pashë Topanit, ndonëse e urrente, i jep ndihmë për të formuar qeverinë e ndarë shqiptare. Një gabim i rëndë i Konicës, që nuk iu fal me vite, kurrë. Po në këtë vit, më 1913, Faik Konica zgjidhet kryetar i Kongresit Shqiptar të Trieshtës dhe pati bashkëbisedime me ministrat e jashtëm të Austro-Hungarisë dhe të Italisë. Konica mbeti në Shqipëri gjatë sundimit gjashtëmuor të princit Vilhelm Vid në vitin 1914, po nuk mori pjesë në poste qeveritare edhe pse ishte më i shquari në Shqipëri; nuk bashkëpunonte me askënd dhe nuk i besonte askujt. Më 1914 një kohë është Konsull i përgjithshëm i Shqipërisë në Uashington.

Kur fillon Lufta e Parë Botërore, më 1914 shkon në Vjenë, ku mbetet deri në fund të luftës. Me Vjenën e lidhnin punë të hershme rreth Albanisë; mendohet se austriakët e kishin financuar deri në fund të luftës edhe pse revista kishte pushuar të dilte më 1909. Aty, në Vjenë, u njoh dhe u miqësua me Ahmet Zogollin, që më vonë u bë Mbreti Zog. Mbas mbarimit të luftës, më 1920, shkon në Romë, ku nuk e pranon postin e delegatit të Shqipërisë. Një vit më vonë, më 1921, kthehet në Boston, Amerikë, dhe del në krye të Vatrës e lufton për një Shqipëri të lirë. Nën udhëheqjen e Konicës, Vatra zu të botonte në Korçë një të përjavshme "Shqiptari i Amerikës", e cila pushoi së dali, kur më 1924 Noli e fitoi pushtetin duke ndjekur Zogun. Kur Zogu u kthye sërish në pushtet, Konica filloi të flasë me Zogun duke pranuar se e kishte mundur "në lojë". Më 1926 Zogu e vendosi Faik Konicën ministër fuqiplotë të Shqipërisë në Amerikë, ku ky ngeli deri në pranverën e vitit 1939, kur Italia e pushtoi Shqipërinë.

Konica vdiq më 15 dhjetor 1942 në Washington. Trupi i tij pushon në Varrezat e Forest Hillsit në Boston. Adhuresit e tij nëpërmjet Vatrës ia ngritën përmendoren ku shkruan: Faik Konica, 15 mars 1876 - 15 dhjetor 1942, Luftëtar i përjetshëm për Pavarësinë shqiptare, Ministër i Shqipërisë në SHBA, 1926 - 1939.¹

C. Veprat

L'Albanie et les Turcs - Libre parole, Paris, 1895;
Albania, Bruksel (1897-1902), Londër (1902-1909).
Në këtë revistë, për trembëdhjetë vjet, u botuan shkrimet kryesore të Konicës; letrare, fletore, atdhetare.

Mémoire sur le mouvement national albanais, Bruksel, janar 1899; vepra është në dorëshkrim frëngjisht në Arkivin e Vjenës.

Albania e vogël (fletore), Bruksel, 1899-1901;

Trumbeta e Krujës (e përkohshme), Sent Luis, 1911;

Jeta e Skënderbeut, 1912;

Marsejeza, në **Trumbeta e Krujës**, 1911;

L'Alemagne et' Albanie, Lozanë, 1915;

Një ambasadë e Zulluve në Paris, në Dielli, 1922;

¹Shënimet biografike për Konicën i morëm kryesisht nga parathënia Shqipërisë që e ka bërë Qerim Panariti, sepse ky vetë tregon se këto shënime janë marrë nga shënimet e vetë Konicës dhe duhet të jenë më të besueshme; mandej nga dy artikujt e Namik Resulit për Konicën: në **Shkrimtarët shqiptarë** dhe në **Faik Konitza: si dhe nxorëm shënime nga vepra e tij**. Shënimet bibliografike i ndërtuam nga burime të ndryshme, që patëm mundësi të njohim e të kemi në dorë. Po këto nuk janë të plota, përderisa të hartohet bibliografia e plotë e Faik Konicës.

Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurasit, në Dielli, 1924;

Shqipëria si m'u duk, në Dielli, 1929;

Në Hijen e Hurmave, përkthim e rikrijim i një zgjedhjeje të përrallave arab nga Një mijë e njëzet, 1924;

Fytyra e turinj të Shqipërisë;

Albania, The Rock Garden of Southeastern Europe, Vatra, Boston, Massachussets, 1957/ Kjo vepër mbeti e pambaruar në dorëshkrim kur vdiq Konica; e redaktoi dhe e përgatiti Qerim Panariti. Përkthimi i saj i parë në shqip u botua në Prishtinë nga shtëpia botuese Gjon Buzuku, më 1961.

LEVIZJA KOMBETARE SHQIPTARE

I. Njoftimet e para

Parashtresa mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, të cilën Faik Konica e shkroi në Bruksel në kallnor të vitit 1899, është destinuar për Ministrinë e Jashtme të Austrisë, dhe nuk është botuar asnjëherë deri më tash. Teksti është në dorëshkrim në frëngjisht dhe ka tetëdhjetë e katër faqe(84); ndodhet në Arkivin e Vjenës.²

Dorëshkrimi i **Parashtresës**, siç e thotë vetë titulli, rrok trajtimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në tërësinë e saj, si ide dhe si realizim, më tepër hipotetikiisht. Teksti është ndërtuar me një sistem të theksuar dhe merret me të ngjarat, dukuritë, idetë dhe njerzit, duke i lidhur me kohën. **Parashtresa** është e ndarë në pesë pjesë: e para (deri

² Faik Konitza. *Mémoire sur le mouvement national albanais*, Bruxelles, janvier, 1899. Signatura :Haus, Hof-und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv XIV/Albanien, Liasse Albanien XII/2 Karton 18. Ne kemi në dorë fortokopjen e këtij dorëshkrimi të Konicës që pati mirësinë të na e japë dr. Abdullah Karjagdiu. Faik Konica. *Parashtresë mbi lëvizjen kombëtare shqiptare*, përktheu nga frëngjishtja Sabri Hamiti, Ora, nr.17,18,19-20, Prishtinë, 1991.